



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
K O R Ç Ë**

VENDIM

Nr 15 Datë 19.09.2008

**Për vendosjen e gjobave nga Inspektorët e Drejtorisë të Kontroll
Territorit në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kontroll Territorit, bazuar në Ligjin në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" si dhe ligjit Nr.7697 datë 07.04.1993 "Për kundërvajtjen administrative", ndryshuar me ligjin Nr.7813 datë 14.04.1994, ligji Nr. 7927 datë 24.04.1995, ligji Nr.8277 datë 15.01.1998, ligji Nr.8542 datë 06.05.1998 dhe ligji Nr.9119 datë 24.07.2003 neni 5 "Niveli i dënimit me gjobë dhe gjoba në vend në rastet e shkeljes të një rëndësie të vogël, për kundërvajtjet e parashikuara në aktet e bashkisë dhe e komunës, përcaktohet me vendime të këshillit përkatës".

VENDOSI :

Të miratojë llojet dhe nivelet e gjobave si më poshtë vijon:

1. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licensë, autorizim apo leje përkatëse të jetë si më poshtë :

a. Mospajisja me licensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti:	
• motokarro	2.000 lek
• transport udhëtarësh taksi (1+4)	10.000 lek
• transport udhëtarësh taksi (1+8)	15.000 lek
• mjete të tonazhit të lartë	20.000 lek
• hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të lartë	15.000 lek
b. Mospajisje me leje për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit	10.000 deri 50.000 lek
d. Mos pajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë.	5.000 deri 10.000 lek
e. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit	5.000 deri 10.000 lek/tavolinë
f. Mos pajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh"	10.000 deri 20.000 lek
g. Mos pajisje me leje për zenie të hapësirës publike	
• ekspozim malli	5.000 deri 10.000 lek
• veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike	5.000 deri 10.000 lek
h. Mospajisje me leje për vendosje reklame:	
• e thjeshte	10.000 deri 15.000 lek
• elektronike	20.000 deri 25.000 lek
i. Mosmarja e masave për izolimin e ambjentit për daljen e zhurmave nga ambjentet e lokaleve.	25.000 lek

2. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore të jetë si më poshtë:

a. Dëmtim rruge	10.000 deri 30.000 lek/ m ²
b. Carje rruge	30.000 deri 50.000 lek/ m ²
d. Bllokim rruge	5.000 deri 20.000 lek/ml
i. Dëmtim bordure	10.000 deri 20.000 lek/ml
f. Dëmtim trotuari	10.000 deri 30.000 lek/ m ²
g. Carje trotuari	30.000 deri 50.000 lek/ m ²
h. Bllokim trotuari	5.000 deri 20.000 lek/ml

Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	10.000 deri 30.000 lek/copë
a. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punime në qytet : -persona juridik -persona fizik -qytetar	50.000 lek 20.000 lek 5.000 lek
3. Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor të jetë si më poshtë:	
a. Lidhje e pamiraturar në rrjetin ajror	10.000 deri 20.000 lek/copë
b. Dëmtim të shtyllave të ndriçimit	20.000 deri 30.000lek/copë
c. Dëmtim i ndriçuesve	5.000 deri 10.000 lek/copë
c. Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj.	5.000 deri 10.000 lek/copë
d. Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkullja e shtyllave	20.000 deri 40.000 lek/copë
e. Ndërrhyrje në kuadrot elektrik publik	10.000 deri 20.000 lek/copë
4. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërrhyrje në rrjetin e ujësjellësit:	
a. Lidhje e pa miraturar në tubacion	10.000 deri 20.000 lek/copë
b. Dëmtim i pusetave	10.000 deri 20.000 lek/copë
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje	20.000 deri 40.000 lek/copë
5. Niveli i gjobave për ndërrhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë :	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelberta	10.000 deri 20.000lek/m ²
b. Dëmtim, prerje e pemëve	10.000 deri 50.000lek/copë
c. Zënie e hapësirës të gjelbër pa leje	5.000 deri 20.000lek/m ²
d. Vendosje tabelash pankartash, banderolash pa leje	1.000 deri 10.000lek/copë
e. Vendosje posterash pa leje	100 deri 200 lek/copë
h. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeveurbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate	10.000 lek

6.Niveli i gjobave per inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë :

a. Për mishin e therur të tregtuar të pa certifikuar nga Inspektoriati Veterinar	5.000 deri 10.000 lek
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë.	10.000 deri 20.000 për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskim të kafshës
c. Në rast të mosmarjes së masave për izolimin kafshëve te luksit	2.000 deri 5.000 lek

8. Të ardhurat e realizuara nga mbledhja e gjobave do të ndahen sipas percaktimit që bën ligji Nr.7697 datë 07.04.1993 “Për kundërvajtjen, administrative”, te ndryshuar.

9. Mbeten në fuqi të gjitha gjobat e tjera që janë miratuar me ligj ose me V.K.B dhe që nuk janë përmendur në këtë material.

10. Përfshihen nga pagimi i gjobave vetëm rastet e parashikuara me ligj të veçantë.

11. Në zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë në Bashki e veçanërisht Drejtoria e Kontroll Territorit.

12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Raimonda Nase
Raimonda NASE